



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.133/24

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ramush Bardiqi, kryetar i kolegjit, Krenar Berisha dhe Dren Rogova anëtarë të kolegjit, çështjen juridike kontestimore të paditësit Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës, me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Nexhmije Karaqi, avokate shtetërore, kundër të paditurës “Jona Med”, sh.p.k, me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Ardi Sheholli, avokat nga Prishtina, për kompensim dëmi kontraktues, vlera e objektit të kontestit prej 25,717.00 €, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të paraqitur kundër aktgjykimi të Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Ekonomik, I.EK.NR.441/18 të datës 16.06.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 15.07.2022, merr këtë:

### A K T V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa e paditësit Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës, me seli në Prishtinë.

II. PRISHET Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Ekonomik, I.EK.NR.441/18 të datës 16.06.2022, dhe lënda i kthehet Gjykatës Komerciale, dhomave të shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosije.

### A r s y e t i m

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Ekonomik me aktgjykimin KE.nr.1380/2022 të datës 24.04.2023, ka vendosur si në vijim: “I. Refuzohet si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës, me seli në Prishtinë e paraqitur kundër të paditurit “Jona Med”, sh.p.k, me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që në emër kompensimit të dëmit kontraktues, t’ia paguaj shumën prej 25,717.00 €. Ndërsa në piken dy te aktgjykimin ka vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur i paditësi, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e paditësit të prishet aktgjykimi i ankimuar në tërësi, dhe të aprovohet kërkesëpadia e paditësit në tërësi si e pa bazuar, ose çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Tutje në ankesë ka deklaruar se paditësi dhe i padituri me dt. 26.06.2009, kanë lidhur Kontratën për furnizim me barna dhe material shpenzues medicinal. Pastaj, me dt. 09.12.2009, kanë vazhduar kontratën e lidhur. Për arsye të mosplotësisë të kushteve në baze në baze të standardeve të caktuara të medikamenteve, me urdhër të Departamentit Farmaceutik të Ministrisë së Shëndetësisë, nga ana e operatorit ekonomik-tani këtu paditësit, është bërë tërheqja e sasisë së 20511 paketime të Produktit Paracetamol sir 120mg/5 ml, me nr.serik 914X dhe me datën e skadimit 20.08.2014.

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e ankimuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës, ka paraqitur padi kundër të paditurit Jona Med, sh.p.k, me seli në Prishtinë. Në padi dhe në parashtrimet e paraqitura gojarisht dhe me shkrim, ndër të tjera ka theksuar: Paditësi dhe i padituri me dt. 26.06.2009, kanë lidhur Kontratën për furnizim me barna dhe material shpenzues medicinal. Pastaj, me dt. 09.12.2009, kanë vazhduar kontratën e lidhur. Nga ky raport kontraktues, i padituri ka dorëzuar mallra sipas porosisë, ndërsa paditësi ka paguar çmimin. Kontesti në mes të palëve ka lindur lidhur me produktin Cysplatin Mylan 50 mg/50 ml (1mg/1 ml). Me dt. 04.10.2010, i padituri ka njoftuar paditësin se Kompania Mylan ka urdhëruar tërheqjen e produktit të lartcekur nga tregu. Me dt. 05.10.2022, paditësi ka kërkuar nga të gjitha institucionet përkatëse të vendit që të identifikojnë produktin dhe të kthejnë në depon qendrore të paditësit. Me dt. 05.12.2010, ka kërkuar nga i padituri kthimin e mjeteve për 1730 copë të produkte Cysplatin Mylan, me vlerë prej 25,717.70 €, të cilin obligim i padituri nuk e ka përmbush. Me padi ka propozuar që gjykata të nxjerrë aktgjykim me të cilin do të detyrohet i padituri që të bëjë kthimin e shumës së lartpërmendur (25,717.70 €).

I padituri, në përgjigje në padi dhe në parashtrimet e mëvonshme gjatë këtij gjykimi, e ka kontestuar kërkesëpadinë si të pabazuar dhe ka propozuar refuzimin e saj. Ndër të tjera ka theksuar se i padituri është furnizuar nga prodhuesi – Kompania Mylan, me produktin kontestues Cysplatin Mylan, të cilin pastaj ia ka liferuar paditësit. Prodhuesi Mylan ka kërkuar nga të gjithë partnerët afarist duke e përfshirë edhe të paditurin, që të tërheqin nga tregu disa seri të produktit Cysplatin Mylan. I padituri ka kërkuar nga paditësi që të bëjë identifikimin dhe izolimin e produktit në një pikë të vetme, për ta ekzaminuar pastaj me ekspertët e vet, dhe për të parë se cilat seri duhet të tërhiqen nga tregu. Paditësi nuk ka bashkëpunuar me të paditurin respektivisht nuk ia ka

mundësuar identifikimin e produktit, tërheqjen e tij dhe pastaj shkatërrimin e tij si një proces i detyrueshëm. I padituri, edhe sot pas 12 vitesh nuk e ka informatën zyrtare nga paditësi se çfarë ka ndodhur me mallin, a është tërhequr nga tregu, nëse po në çfarë sasive.

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, me Aktgjykimin L.EK.nr. 441/18 të datës 14.07.2022, pas administrimit të provave ka gjetur se padia e paditësit është e pabazuar, tutje në arsyetimin e aktgjykimit ka theksuar se në rastin konkret duhet të zbatohen dispozitat materiale juridike përkitazi me përgjegjësinë për dërgimin e mallit me të meta materiale (LMD, nenet 461-483 të LMD-së). Nga përshkrimi faktik i fakteve vendimtare të rastit, gjykata ka vlerësuar se në rastin konkret ka pasur dyshime se disa seri nga i gjithë kontingjenti i dorëzuar, kanë të meta materiale, gjë që artikujt i bënë të papërdorshëm. Ka qenë e domosdoshme që të ndiqen disa hapa procedural, për të identifikuar mallin me të meta, për të specifikuar sasinë dhe vlerën e atij malli, dhe për rikthimin e atij malli tek i padituri si furnizues. Malli ka qëndruar një kohë të gjatë në disponim të palës paditëse, e cila ka mundësi reale që një pjesë e atij malli ta ketë shpërndarë dhe të jetë shitur. Vetëm rikthimi i mallit në një pikë deponimi dhe ekzaminimi i tij nga vet i padituri si furnitorë, duke aplikuar kriteret profesionale të ekzaminimit, do të mund të vinte në pah se ka pasur apo jo malli të metat për të cilat është dyshuar, e pastaj do të mund të identifikohet edhe sasia për kthim dhe vlera. Nga gjendja faktike e përshkruar më sipër, kemi elaboruar se paditësi si blerës i mallit, ka dështuar që të zbatoj edhe këtë dispozitë ligjore, pasi nuk i ka ndërmarrë veprimet e domosdoshme në drejtim të identifikimit të mallit me të meta, nuk e ka ftuar të paditurin si furnizues për inspektimin e mallit, nuk ka pasur identifikim të sasisë dhe të vlerës së mallit që duhet të tërhiqet nga i padituri dhe në fund nuk është bërë asnjëherë tërheqja e mallit nga pala e paditur. Paditësi ka qenë në raport kontraktues me të paditurin si furnizues e jo me prodhuesin apo ndonjë palë tjetër, prandaj të gjitha aktivitetet përkitazi me identifikimin, izolimin dhe kthimin e mallit është dashur t'i koordinoj me të paditurin. E dyta, paditësi nuk ka qenë transparent si palë kontraktuese me të paditurin dhe i padituri as sot e kësaj dite nuk e ka të njohur se a është shpërndarë për konsum ai mall apo është shkatërruar. Paditësi ka deklaruar se malli është shkatërruar por nuk e ka dëshmuar me provat përkatëse. Madje, për këtë proces kontestimor nuk është relevante se a është shkatërruar malli apo jo, sepse për të fituar të drejtën në zëvendësim të malli apo në kompensim, duhet të kthehet fillimisht malli tek furnitori. Gjykata vlerëson se nuk ka ndonjë mundësi ligjore që edhe të mos kthehet malli tek furnitori edhe të bëhet kthimi i çmimit blerës. Gjykata e ka shqyrtuar edhe pretendimin e paditësit se i gjithë malli ka qenë i ndaluar për qarkullim dhe për shpërndarje nga autoritetet kompetente të Italisë, prej nga e ka origjinën malli kontestues, dhe si i tillë ka qenë me të meta. Mirëpo, edhe ky pretendim nuk ka pasur ndonjë peshë vendimtare sepse edhe në një situatë të tillë do të vlenin dispozitat e lartpërmendura ligjore, që kanë të bëjnë me mallrat me të meta materiale.

Gjykata e shkallës së parë vendimin e saj e ka mbështetur në nenet 461,467-478, 483 të LMD-së, ndërsa vendimin mbi shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në dispozitën e nenit nenin 463.1 të LPK-së.

Dhoma e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes dhe pas ekzaminimit të aktgjykimit të ankimuar, dhe shkresave të tjera të lëndës, e duke pasur parasysh edhe pretendimet

ankimore, gjen se aktgjykimi i kontestuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 të LPK pika nën n) e cila përcakton se: *“në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar fare arsye për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre dokumenteve ose të procesverbalit”*.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë rreth mënyrës së vendosjes sipas aktvendimit të ankimuar, tani për tani, nuk e përkrah Dhoma e Shkallës së Dytë, për shkakun se kjo gjykatë me vlerësimin dhe analizimin e tërësishëm të shkresave të lëndës ka gjetur se aktvendimi i ankimuar është marrë me shkeljet thelbësor të dispozitave ligjor edhe vërtetimi jo te plot dhe te gabuar te gjendjes faktike për të cilën gjykata e shkallës së dytë çdo herë kujdeset sipas detyrës zyrtare ne kuptim te nenit 194 të LPK dhe e cila shkelje sipas vlerësimit të kësaj gjykate ka ardhur si shkak i vërtetimit jo te plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike me rastin e vendosjes nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Për më tepër, dispozitivi i aktvendimit të ankimuar, është kontradiktor dhe në kundërshtim me arsyet mbi faktet vendimtare në të cilat është thirrur gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes, sepse i njëjti është marrë edhe me shkelje procedurale pasi që në rastin konkret nuk është vërtetuar plotësisht gjendja faktike.

Aktgjykimi i goditur është i mangët dhe nuk përmban te gjitha elementet dhe pikat e vlerësimit për secilën pretendim te propozuesit, për një vendim te arsyetuar, sepse nuk i janë adresuar argumentet thelbësore, me rastin e vlerësimit, për arsye se gjykata e shkallës së parë nuk ka arsyetuar refuzimin e propozimit te paditësit për nxjerrjen e provës përmes ekspertizës as ne seancën e shqyrtimit kryesor dhe as aktgjykimin e atakuar me ç’rast ka bere shkelje te dispozitave ligjit te procedurës kontestimore ne baze te nenit 183 te LPK-se pasi nuk a vërtetuar ne mënyre te plot gjendjen faktike.. Kjo gjendje faktike, konsiderohet e pavërtetuar në tërësi, marr parasysht këtu se mos aprovimi i propozimit të nxjerrjen e provës përmes ekspertizës, i eshte mohuar paditesit parashtrimi i provave e përmes se cilës do te vërtetohen faktet vendimtare, përkatësisht do te konstatohet një gjendje e drejte faktike mbi baze e te cilës edhe do te aplikohet drejte edhe e drejta materiale. Rrjedhimisht, Gjykata ne rrethanat e rastit konkret, duke marre parasysh qe Gjykata e shkallës së parë, ka dështuar te adresojë dhe arsyetojë pretendimet thelbësore te parashtruesit te kërkesës te ngritura para saj, andaj, aktgjykimi i atakuar nuk është ne përputhje me standardet e një vendimi te arsyetuar gjyqësor, siç janë te përcaktuar përmes nenit 31 te Kushtetutës ne lidhje me nenin 6 te KEDNJ-se dhe praktikës gjyqësore te GJEDNJ-se.

Në lidhje me pretendimet ankimore të palës së paditësit, kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes në arsyetim të aktgjykimit është dashur ti jep të gjitha vlerësimet e saj, në lidhje me të gjitha çështjet e ngritura nga palët ndërgjyqëse. Gjykata e shkallës së parë ka pasur për obligim që në arsyetim të aktvendimit të trajtojë të gjitha kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat ne drejtim te vlerësimit te propozimit për marrjen e provës përmes ekspertizës. Në këtë drejtim, gjykata e shkallës së parë ka dështuar të jep sqarime të nevojshme në arsyetim të aktgjykimit në lidhje me pretendimet e palës propozues për nxjerrjen e provës përmes

ekspertizës. Në mungesë të një vlerësimi profesional dhe të argumentuar nga ana e ekspertit financiar, rezulton se gjendja faktike në rastin konkret nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, ku si pasojë ka ardhur edhe deri tek zbatimi i gabuar i të drejtës materiale.

Kolegji i Gjykatës Komerciale- Dhoma e shkallës së dytë, pas analizimit dhe shqyrtimit me kujdes të shtuar të provave që gjenden në shkresat e lëndës e në raport me pretendimet ankimore erdh në përfundim se ankesa është e bazuar, për arsye se aktvendimi i atakuar ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet sepse dispozitivi i aktvendimit është i pakuptueshëm, kontradiktor me vetvete si dhe ekzistojnë kundërthënie për faktet vendimtare midis asaj që jepet në arsyet e aktvendimit dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, respektivisht në arsyetim të aktvendimit nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka refuzuar si të pabazuar padinë e paditësit, pa qartësuar plotësisht gjendjen faktike dhe juridike të çështjes respektivisht pa vërtetuar me prova faktet vendimtare kontestuese sepse nga arsyetimi i aktgjykimi i atakuar nuk është e qarte se si gjykata e shkallës së parë ka ardhur te përfundimi se padia është e pabazuar.

Kolegji i kësaj gjykate nuk pajtohet me qëndrimin juridik të gjykatës të shkallës së parë, *‘se paditësja në padi nuk i është referuar asnjë baze ligjore, për këtë proces kontestimor nuk është relevante se a është shkatërruar malli apo jo, sepse për të fituar të drejtën në zëvendësim të malli apo në kompensim, duhet të kthehet fillimisht malli tek furnitori. Gjykata vlerëson se nuk ka ndonjë mundësi ligjore që edhe të mos kthehet malli tek furnitori edhe të bëhet kthimi i çmimit blerës, dhe paditësi është dashtë të kontaktoj vetëm paditurën që ka qenë në raport kontraktues me të paditurin si furnizues e jo me prodhuesin apo ndonjë palë tjetër. Ndërsa lidhur me pretendimin se i gjithë malli ka qene i ndaluar për qarkullim dhe për shpërndarje nga autoritetet kompetentet të Italisë, prej nga e ka origjinë malli kontestues, dhe si i tillë ka qene me të meta, gjykata ka konsideruar se ky pretendim nuk ka ndonjë peshë vendimtare pasi edhe për një situatë të tillë do të vlenin dispozitat e lartpërmendura ligjore’*. Kolegji i kësaj gjykate nuk i mbështet këto arsyetime të vendimit të atakuar për arsye se, në bazë të dispozitave të LPK-së nuk është e detyrueshme përcaktimi i bazës ligjore në padi përkatësisht, neni 253.2 parasheh se: *‘Gjykata nuk është e lidhur me bazën juridike të kërkesëpadsisë. 253.3 Gjykata do të veprojë sipas padsisë edhe kur paditësi nuk e ka treguar bazën juridike të kërkesëpadsisë’*. Ndërsa lidhur me zëvendësimin e mallit ka qene detyrë e paditësit të zëvendësojë mallin me të meta pas njoftimit të paditësit me dt. 21.05.2010, Ndërsa çështja se malli është dashtë të kthehet tek e paditura për të zëvendësuar mallin, Kolegji vlerëson se malli i cili është konstatuar se është me të meta për shkak të skadimit nuk mund të kthehet të paditësi për shkak se një malli i tillë tani dyshohet se është jashtë qarkullimit juridik sipas pretendimeve të paditëse dhe shkresave të lëndës pasi në bazë të shkresës së autoriteteve italiane të barnave (AIFAS deklaroi se prej dt. 06.07.2009, prodhuesi ECOBY nuk posedon autorizim Marketing valid. Kolegji vlerëson se është kompetencë e organeve kompetentet të trajtoj këtë mall sipas procedurave të përcaktuara me ligji. Ndërsa është kompetencë e Ministrisë së Shëndetësisë që të kujdeset për shëndetin publik dhe mos të rrezikohet shëndeti publik me furnizimin e një mallit që është jashtë afatit të përdorimit. Andaj, kolegji vlerëson se është nevojshme nxjerrja

provës përmes ekspertizës përkatëse profesionale me te cilën do te identifikohet se furnizimi i mallit a është bere para apo pas tërheqjes se autorizimit, ne baze te te cilat do te vërtetohen dhe sqarohen faktet vendimtare ne këtë çështje juridike. Pra duhet te sqarohet se furnizuesi i malli a e ka liferuar mallin i cili është objekt kontratës ne baze te kontratës mes palëve ndërgjyqëse dhe te identifikohet se ky mall a ka pas autorizimin nevojshme qe te jete qarkullim juridik ne periudhën e furnizimit, a i është i pajisur me banderola mall dhe a është asgjësuar nga autoritete kompetente apo ku gjendet ky mall dhe varësisht nga këto konstatime dhe ne lidhmëni ne provat te cilat gjenden ne shkresa te lendes apo prova tjera eventuale te jepen arsye te qarta ne lidhje me kërkesën padinë e paditësit për kompensimin e demit kontraktues, dhe mbi një gjendje te tillë faktike te zbatohet drejte edhe e drejta materiale.

Ndërsa lidhur me çështjen se malli ka qene i ndaluar për qarkullim, ne rrethanat e një suate te tille juridike, se nëse një mall është jashtë qarkullimit juridik, Kolegji vlerëson se aplikohen dispozitat e nenit 441.2 të LMD-së Sendi që është objekt i kontratës duhet të jetë në qarkullim. Është nule kontrata për shitjen e sendit, i cili është jashtë qarkullimit ndërsa paragrafi 2 i po këtij neni ka paraparë: Për shitjen e sendeve, qarkullimi i të cilave është i kufizuar vlejnjë dispozita të veçanta. Në rastin konkret si sende që mund të vihen në qarkullim janë vetëm ato sende që mund të blihen, të shiten ose të këmbehen ndërsa produktet farmaceutike si sende me qarkullim të kufizuar mund të plasohen në treg, vetëm me dhënien autorizimeve për këtë mall.

Kolegji i kësaj gjykate nuk mbështet vlerësimet juridike dhe faktike te gjykatëse shkalles se pare për arsye se, ne një rën ane gjykata e shkalles e pare ka konstatuar se malli ka qene ne posedim te paditësi dhe ka mundësi te jete shitur nga pala paditës, duke ngritur hipoteza te tilla pa referimin e asnjë prove, pa specifikuar sa ishte sasia e mallit dhe vlera e tije, ndërsa ne anën tjetër nuk ka nxjerr prova, mbi baze e te cilave do te dihej se sa ishte sasia dhe vlera e malit ne rastin konkret.

Kolegji i kësaj gjykata ne baze te shkresave te lendes, dhe ne kontest te argumenteve ligjore ka gjetur se, Gjykata e shkalles se pare nuk ka shqyrtuar fare provat e cila gjendet ne shkresa te lendes përkatësisht Raport i dt. 31.03.2010, andaj e paditura ne ri procedurë duhet te shqyrtoj këtë prove dhe te deklarohet lidhur me këtë prove si dhe te nxjerr provën përmes ekspertize me te cilën te vërtetohet ne mënyrë te plot dhe te drejte gjendja faktike. Bazuar në të lartëcekurat, rezulton se gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e atakuar e ka marrë me shkelje të nenit 8 të LPK-së, për arsye se nuk i ka vlerësuar me kujdes të veçantë secilën provë veç e veç dhe të gjitha së bashku. Sipas Nenit 8.2 të LPK-së, gjykata ka për obligim që me ndërgjegje dhe me kujdes ta çmojë çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku për të ardhur te e vërteta materiale. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka marrë vendimin e atakuar, pa qartësuar plotësisht gjendjen faktike dhe juridike të çështjes. Kolegji nga arsyet e dhëna si më lartë ka arritur në përfundim se është dashur që aktgjykimi i shkallës së të parë të priset, për faktin se e drejta materiale nga gjykata e shkallës së parë është aplikuar mbi gjendjen faktike të pa vërtetuar në mënyrë të plotë.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë sipas aktvendimit të ankimuar, tani për tani, nuk e përkrah Dhoma e Shkallës së Dytë, për shkakun se kjo gjykatë me vlerësimin dhe analizimin e tërësishëm të shkresave të lëndës ka gjetur se aktvendimi i ankimuar është marrë me shkeljet thelbësor

te dispozitave ligjor edhe vërtetimi jo te plot te gjendjes faktike dhe si rezultat i kësaj tani për tani edhe me zbatim te gabuar te drejtës materiale për të cilën gjykata e shkallës së dytë çdo herë kujdeset sipas detyrës zyrtare ne kuptim te nenit 194 të LPK. Mos vërtetimi i vlefshmërisë së provave kontestuese, si prova të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejte në nxjerrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë, përbejnë shkelje të dispozitës së Nenit 183.1 të LPK-së, i cili përcakton se ekziston vërtetim i gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike kur gjykata gabimisht e ka vërtetuar ndonjë fakt vendimtar, përkatësisht kur faktin e tillë nuk e ka vërtetuar fare.

Gjykata e shkallës së parë, duhet ti shqyrtojë të gjitha vërejtjet e dhëna nga kolegji i kësaj gjykate, ti eliminoj të gjitha shkeljet e theksuara më lartë, të vendos në kuptim të nenit 160 të LPK-së, ashtu që dispozitivit dhe arsytimi i vendimit të jetë i çartë dhe i kuptueshëm, të vendos për të gjitha kërkesat e palëve në procedurë, ti vlerësoj të gjitha provat veç e veç dhe të gjitha së bashku, dhe në fund të merr vendim të drejtë dhe të ligjshëm. Gjithashtu gjykata të marrë parasysh pretendimet e palëve gjatë procedurës, provat në shkresat e lëndës, të vlerësohen një nga një dhe të ndërlidhura në mes vete, ashtu që të krijohen kushtet që gjykata të vendos lidhur me kërkesëpadinë, duke marrë vendim të drejtë dhe të ligjshëm, dhe të arsyetuar për faktet vendimtare, konform dispozitës së nenit 160 të LPK-së.

Kolegji vlerëson se në procedurën para gjykatës së shkallës së parë gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë, pasi qe nuk është aprovuar propozimi i paditësit për nxjerrjen e provës përmes ekspertize, pa arsyetuar fare se perse nuk është aprovuar propozimi. Me ç'rast i është mohuar palës paditësit qe te prezantoj prova para gjykatës ne drejtim te vërtetimit te gjendjes faktike. Kjo do të thotë që secilës palë duhet t'i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur rastin e saj, në kushte që nuk e vendosin atë në një disavantazh të konsiderueshëm vis a vis palës kundërshtare, për me tej gjykata konsideron se ne rrethanat e rastit konkret është shkel parimi i barazisë së armëve në mes të palëve i cili është kusht thelbësor i shqyrtimit të drejtë. Kolegji vlerëson se ne vështrim te neni 356 LPK-se Gjykata, me propozimin e palëve mundë të bëjë të provuarit me anë të ekspertizës, sa herë që për vërtetimin apo sqarimin e fakteve, apo të rrethanave të caktuara nevojitet dijeni profesionale të cilën nuk e ka gjyqtari i çështjes.

Për shkak te shkeljeve thelbësorë te dispozitave procedurës kontestimore, konstatim jo te plot te gjendjes faktike tani për tani vlerësohet se edhe e drejta materiale është zbatuar ne mënyre te gabuar, prandaj udhëzohet gjykata e shkallës së parë qe ne ri procedurë te beje eliminimin e shkeljeve te sipër theksuara ne atë mënyre qe te aprovoj propozimin për marre provën përmes ekspertizës përkatës profesionale duke caktuar detyra te qarta ekspertin ne baze te propozuesit te ekspertizës dhe për nevojat e gjykate ne mënyre e te vije deri te e vërtetimi i plot i gjendjes faktike dhe varësisht nga vërtetimi gjendje faktike te zbatohet drejte e drejta materiale. Andaj, Gjykata e shkallës së parë në riprocedurë duhet t'i ftoj palët dhe të hap shqyrtimin kryesor, të bëjë administrimin dhe vlerësimin e të gjithave provave materiale veç e veç dhe në mënyrë të tërësishme, ato që gjenden në shkresat e lëndës apo prova të tjera eventuale që do të paraqiteshin nga palët.

Nga te cekurat me lart, e në mbështetje të nenit 194, 195 paragrafi 1, pika c) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË**

**Dhomat e Shkallës së Dytë**

**K.DH.SH.II.nr.133/24, me datë 07.03.2024**

**Kryetari i Kolegjit – Gjyqtari,  
Ramush Bardiqi**